

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i regjistruar në BQK, me mision që të siguroj qasje në shërbimet financiare për individët me të ardhura të ulëta, në zonat rurale dhe urbane të Kosovës, me prioritet në sektorin e bujqësisë me qëllim që të influencojë zhvillimin e bujqësisë dhe aktivitetëve tjera ekonomike në zonat urbane.

Prandaj, Kreditimi Rural i Kosovës Sh.p.k rishpall:

K O N K U R S

Për rekrutim të **Një (1) Analist-e Kreditor-e** për degën në **Gjilan**

Përgjegjësitë :

- Promovimi i ofertës kreditore,
- Analiza e kërkesave kreditore, prezantimi i tyre në komitetin kreditor dhe vlerësimi i kolateralit,
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e kredive, mbikëqyrja e kthimit të kredive dhe regjistrimi i tyre në programin adekuat,
- Raportim në zyrën qendrore për aktivitetin kreditor,
- Punë të tjera administrative të ndërlidhura me kredi-dhënien.

Kushtet e kërkuara:

- Diplomë universitare në ekonomi apo bujqësi, etj.(e preferueshme),
- Përvojë pune në sektorin mikro-financiar apo bankarë (e preferueshme),
- Njohuri për kredi-dhënie dhe të jete i/e motivuar të punoj në zona rurale dhe urbane,
- Njohuri të mira të punës me kompjuter, të njoh Microsoft Office,
- Shkathësi të mira të komunikimit dhe negocimit,
- Të jete dinamik, fleksibil, kreativ dhe i gatshëm për punë në ekip,
- Njohuri të gjuhës angleze (e preferueshme),
- Banor i komunës për të cilën konkurren (e preferueshme),
- Të posedoj patentë shofer për kategorinë B.

Konkursi mbetet i hapur nga dt. **07.03.2018** deri me dt. **13.03.2018**. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë vetëm duke plotësuar aplikacionin në linkun: <http://krk-ks.com/vendepune/job-list?id=426>

Vetëm një numër i përzgjedhur i kandidatëve do të ftohet në intervistë.